

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2021

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke konsideruar Komisionin e Prokurimit Publik si organin më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm për KPP-në paanësinë në vendimmarrje, transparencën, efikasitetin dhe në mënyrë të veçantë mbrojtjen e interesit publik përmes një administrate të përgjegjshme, e cila mirëmenaxhon fondet publike, si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve kontraktore;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm rolin që KPP-ja ka në rritjen e efikasitetit dhe të besueshmërisë në sistemin e prokurimit publik;

Duke vlerësuar si një arritje tepër të rëndësishme implementimin e reformës së digjitalizimit të shërbimeve dhe menaxhimit të ankesave, me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e transparencës dhe minimizimin e korrupsionit;

Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2021 dhe vlerëson:

Punën e bërë për finalizimin me sukses të projektit të digjitalizimit si një hap i rëndësishëm për një institucion më transparent, më të hapur dhe që mundëson akses të plotë për të gjithë operatorët ekonomikë, vendas dhe të huaj, të dorëzojnë elektronikisht ankesat dhe argumentet e tyre si dy shërbime të veçuara, duke zëruar kostot ekstra dhe kontaktin e drejtpërdrejtë me çdo zyrtar shteti, përfshirë edhe vetë Komisionin e Prokurimit Publik.

Përpjekjet për uljen e numrit të ankesave të shqyrtuara jashtë afatit dhe rritjen e shpejtësisë së kohës së vendimmarrjes gjatë vitit 2021 krahasuar me një vit më parë, duke përgjysmuar numrin e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit krahasuar me një vit më parë.

Masat e marra në kuadër të transparencës ndaj qytetarëve për pasqyrimin në faqen zyrtare jo vetëm të vendimeve të marra gjatë vitit 2020, por edhe të vendimeve të marra gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019. Faqja e re e KPP-së në internet mundëson tanimë akses në tre regjistra publike: atë të ankesave, vendimeve dhe historikut të vendimeve. Njëkohësisht faqja e re mundëson akses për personat me probleme në shikim (verbëri, verbëri ngjyrash dhe shikim të dobët) nëpërmjet një motori të veçantë aksesit.

Punën e bërë për vendosjen e praktikave të konsoliduara për trajtimin e çështjeve të reja për këtë institucion lidhur me ndryshimet thelbësore materiale dhe procedurale që ka sjellë hyrja në fuqi e ligjit të ri në procesin e shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimit publik.

Punën e bërë për hartimin dhe miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e institucionit, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit të ri të prokurimit publik.

Bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës dhe Gjykatën Administrative të Apelit për trajnimin e punonjësve të të dyja institucioneve, me qëllim aftësimin e tyre në trajtimin e çështjeve komplekse të prokurimit publik.

Bashkëpunimin me Universitetin e Tiranës për hartimin e një kurrikule të posaçme trajnimi për zyrtarët e KPP-së, në sajë të të cilit është bërë i mundur trajnimi i punonjësve nga pedagogët e tri fakulteteve kryesore në vend, përkatësisht: Fakultetit Juridik, Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

Miratimin e disa vendimeve interpretuese lidhur me çështje specifike me rëndësi për sistemin, me synim shmangien e përsëritjes së problematikave të konstatuara.

Me gjithë përmirësimet e bëra kemi akoma një numër ankesash të cilat janë shqyrtuar jashtë afateve ligjore.

Numri i ankesave të mospranuara për shkaqe të mosplotësimit të kriterëve formale është relativisht i lartë.

Operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore duhet të jenë më të informuar lidhur me ndryshimet në legjislacionin e prokurimit publik.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2022 kërkon që Komisioni i Prokurimit Publik të angazhohet veçanërisht në këto aspekte të veprimtarisë së tij:

1. Të investohet me kapacitet të plotë për uljen e numrit të ankesave të shqyrtuara jashtë afateve ligjore, duke ndjekur trendin përmirësues të vitit 2021.

2. Të punojë për plotësimin e vendeve vakante, duke rekrutuar profesionistë të kualifikuar të fushës, si një faktor i cili ndikon drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit dhe cilësinë e vendimmarrjes së KPP-së dhe në të njëjtën kohë të vijoje punën për trajnimin e punonjësve të Komisionit të Prokurimit Publik, me qëllim rritjen dhe forcimin e kapaciteteve profesionale në vazhdimësi.

3. Të angazhohet në vazhdimësi për informimin e operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve kontraktore përmes organizimit të tryezave/fushatave informuese, si dhe të hartojë kurrikulat e trajnimit për zyrtarët e prokurimit, komisionin e vlerësimit të ofertave, me qëllim uljen e numrit të ankesave të mospranuara për shkaqe të mosplotësimit të kriterëve formale, si dhe të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së punës nga ana e autoriteteve kontraktore.

4. Të rrisë përpjekjet për ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë për përdorimin e sistemit të ri të dorëzimit të ankesave *online* nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*, si dhe të miratojë manualët e përdorimit të Sistemit të Ankesave Elektronike për operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore.

5. Të bashkëpunojë ngushtësisht me Agjencinë e Prokurimit Publik për të bërë të mundur krijimin e standardeve të njëjta në trajtimin e çështjeve të ngjashme dhe njëkohësisht marrjen në konsideratë nga APP-ja të problematikave të ankesave, duke krijuar kështu një model pune.

6. KPP-ja në vijim të procesit të digjitalizimit të punojë për implementimin e fazës së dytë për integrimin e proceseve të brendshme administrative në sistemin e dorëzimit dhe shqyrtimit të ankesave (sistemi ERP).

7. Të vijoje monitorimin e zbatimit të vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve të administratës shtetërore, në lidhje me detyrimin për të zbatuar vendimet e KPP-së në kohë, si një detyrim që lidhet drejtpërdrejt me një proces të rregullt ligjor për palët në proces dhe që mbron interesin publik.

8. Të rrisë bashkëpunimin me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkollën e Magjistraturës për krijimin e kurrikulave të përbashkëta të trajnimit, magjistratë dhe zyrtarë prokurimi.

Miraturar në datën 7.7.2022.